



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



DREJTORIA E NDIHMËS
JURIDIKE FALAS

Nr. 1009 Prot
Datë 08.04.2025



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

QENDRA ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM

Nr. 28 Prot
Datë 08.04.2025

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

NDËRMJET

DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS

DHE

QENDRËS ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM

*“Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017
«Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*

Kjo marrëveshje mirëkuptimi lidhet sot më datë ____/____/____

NDËRMJET

Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, me adresë: Rruga “*Jordan Misja*”, Godina nr. 3, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, në mungesë, Drejtori i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Parësore, Zj. Patricia Pogaçe

Dhe

Qendrës Aleanca Gjimore për Zhvillim, me adresë: Rruga “*Abdyl Frashëri*”, P.10/1, Ap.3, Shk.1, Tiranë, përfaqësuar nga zj. Mirela Arqimandriti

Duke qënë se Palët,

Vlerësojnë rëndësinë e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti në kuadër të rritjes së aksesit në drejtësi për qytetarët si një parim themelor kushtetues.

Konsiderojnë se një ndër elementët kyç të aksesit në drejtësi është sigurimi i ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike të garantuara nga shteti në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.

Afirmojnë vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshje.

Kanë rënë dakord të lidhin këtë marrëveshje mirëkuptimi në vijim e quajtur *Marrëveshje*.

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj marrëveshje mes Palëve konsiston në vendosjen e bashkëpunimit sa i përket shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti me qëllim ndërmarrjen e masave për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve dhe në veçanti të grupeve vulnerabël.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo marrëveshje mirëkuptimi bazohet në nenin 8 shkronja “c” të ligjit nr.111/2017 “*Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti*”.

Neni 3

Qëllimi

Palët bien dakord të bashkëpunojnë mbi:

- Promovimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti përmes zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese; edukimit ligjor apo afishimit të materialeve të vizibilitetit, me qëllim sigurimin e aksesit në drejtësi për të gjithë qytetarët;
- Zhvillimin e takimeve për të diskutuar çështjet me interes të përbashkët;
- Planifikimin dhe organizimin e trajnimeve të përbashkëta në këtë kuadër;
- Referim i rasteve për të përfituar ndihmë juridike parësore falas pranë ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore.

Neni 4

Personat e kontaktit

Secila nga palët cakton një person kontakti të cilit i drejtohen të gjitha komunikimet qofshin verbale apo të shkruara, si elektronike ashtu edhe të shtypura në letër.

Në çastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje personat e kontaktit janë si vijon:

Për Qendrën Aleanca Gjinore për Zhvillim:

Znj. Besjana Hysa
Projekt Koordinatorë
besjana.hysa@gmail.com
+355693493678

Për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas:

Zj. Suela Qevani
Përgjegjës Sektori, Drejtoria e Zbatimit të
Politikave dhe Administrimit të Ndihmës
Parësore
suela.qevani@drejtesia.gov.al
+355692406766

Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e ndryshimit, mbi të dhënat e personit të ri të kontaktit.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

Neni 6

Dispozita të fundit

Kjo marrëveshje nuk është burim i krijimit të detyrimeve monetare dhe financiare ndërmjet palëve.

Çdo palë merr përsipër të përmbushë detyrimet sipas kësaj marrëveshjeve pa pretendim financiar ndaj palës tjetër.

Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.


Kjo marrëveshje mirëkuptimi hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

**PËR DREJTORINË E NDIHMËS
JURIDIKE FALAS**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
NË MUNGESË

(DREJTORI I DREJTORISË SË ZBATIMIT
TË POLITIKAVE DHE ADMINISTRIMIT
TË NDIHMËS PARËSORE)

Patricia Pogaçe



**PËR QENDRËN
ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM**

Drejtoresh Ekzekutive

Mirela Arqimandriti

